REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POLIÇAN**
**KOMISIONI I PROKURIMEVE ME VLERA TE VOGLA**

**Poliçan, më 07.10.2024**

# PROCESVERBAL

## PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË VEÇANTA PËR PRANIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "*Shpenzime per blerje mallerash dhe veshje speciale per cerdhen e Bashkise Poliçan"*

**LLOJI I PROCEDURËS:** Procedurë prokurimi me vlerë të vogël

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)** Dyshekë 39143112-4, Batanije 39511100-8, Jastëkë 39516120-9, Çarçafë 39512100-5

I mbajtur sot në datë 07.10.2024 nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, të emëruar sipas Urdhërit Nr.01 datë 03.01.2024 "Për krijimin e Komisionit të prokurimit me vlera të vogla", për procedurën e prokurimit me vlere të vogël me objekt: " *Shpenzime per blerje mallerash dhe veshje speciale per cerdhen e Bashkise Poliçan"*

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimit të AgjencisësëProkurimitPublik, nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e proçedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për realizimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor kërkon nga Operatoret ekonomike kur të paraqiten pranë Bashkise Polican të paraqesin dokumentat si më poshtë:

Kërkesa AK, për blerje bojra printeri lidhet me nevojën për vijueshmërinë e punës. AK, ka hartuar specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar të cilat përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me nenin 36, të LPP-së.

## I. KRITERE TË KUALIFIKIMIT

### 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) -Nje vertetim nga bankat e nivelit te dyte per Nr. IBAN-i dhe te permbaje dhe NIPTIN.
b) Vertetimi te leshuar nga Drejtoria e Tatimeve qe nuk ka detyrime
c) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion

kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

d) Në zbatim të ligjit nr 87/2019"për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" I ndryshuar dhe njoftimit të përbashkët të drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve dhe Agjensise se Prokurimit Publik tatimpaguesit te dates 30.12.2020 , të cilët kryejnë transaksione me entet publike, kanë detyrimit ligjor që të lëshojnë vetëm fatura elektronike për mallrat apo shërbimet e shitura. **Pra fatura që do të lëshohet nga operatori ekonomik fitues do të jetë fature elektronike.**
e) Nje kopje te NIPT dhe ekstraktit te QKR I leshuar jo me shume se 3 muaj nga data e zhvillimit te tenderit
f) Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në QKB dhe të ketë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe të paraqesë deklaratë që:

a) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
b) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional(sipas shtojcës 1 bashkëlidhur).

g) Të dorëzojë deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara (sipas shtojcës 2 bashkëlidhur).
h) Të paraqesë Ofertën Ekonomike për produktin objekt prokurimi (sipas shtojcës 3 bashkëlidhur).
i) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë deklaratë që merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në ambientet e Bashkise Polican

*Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në QKB dhe të ketë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe të paraqesë deklaratë që:*

a) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
b) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional(sipas shtojcës 1 bashkëlidhur).
Të dorëzojë deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara (sipas shtojcës 2 bashkëlidhur).
Të paraqesë Ofertën Ekonomike për produktin objekt prokurimi (sipas shtojcës 3 bashkëlidhur).
Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë deklaratë që merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në ambientet e Bashkise Polican

**Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në nenin 41, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe Udhëzimin Nr. 5, date 25.06.2021 të Agjensisë së Prokurimit Publik, "Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për cilësinë e mallrave te furnizuara

*Bazuar ne pikën 15 gërma a) të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, **nr. 5,datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike",** çdo ofertues do te verifikohet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare te Biznesit. Ne rast se pas verifikimit operatori ekonomik nuk rezulton me status aktiv dhe/ose nuk rezulton të ketë në fushën e veprimtarisë se tij objektin e prokurimit sipas Ekstraktit te Regjistrit, oferta do te refuzohet automatikisht.

-Gjithashtu, do të refuzohet automatikisht edhe oferta e paraqitur nga operatorë ekonomikë, të cilët në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga autoriteti kontraktor gjatë këtij viti, nuk ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

*__Bazuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021__" Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 56 pika 6 , Autoriteti Kontraktor do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm Operatorët Ekonomikë, oferta e të cilëve, nuk është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përllogaritur

**Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, sipas listës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor.**

**a) Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kerkuara nga AK.**

**Specifikimet teknike jane si me poshte:**

| Nr | Emertimi i materialeve | specifikimet | Njesia | Sasia |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Dyshek femijesh | Dyshek me sfungjer fleksibël me përmasa (120 x 60 x 15) cm | cope | 15 |
| 2 | Këllëf dysheku | **Këllëf dysheku-** Këllëf dysheku i përbërë prej materiali pambuku, me veti antibakteriale dhe antialergjike, në pjesën e sipërme të jetë i papërshkrueshëm nga uji dhe në anësore të jetë i pajisur me material elastik, që nuk e lejojnë çarçafin të mblidhet gjatë gjumit, me përmasa 120cm x60cm dhe në ngjyrë të bardhë. | cope | 15 |
| 3 | Çarçaf puliester | **Set çarçafësh-** Set çarçafësh me 3 pjesë për krevat fëmijësh, të përbërë prej materiali 100% pambuku, me veti antibakteriale dhe antialergjike, i cili përfshin një çarçaf për mbulojë me përmasa 170cm x120 cm, një çarçaf për shtrojë me cepa të pajisur me material elastik, që nuk e lejojnë çarçafin të mblidhet gjatë gjumit, me përmasa 120cm x60cm, dhe një këllëf jastëku me përmasa 45cmx 60cm. | cope | 30 |

*1.* Transporti i mallit do te kryhet nga Operatori Ekonomik
*2.* Mallrat qe do te blihen te jene te reja dhe te amballazhuar

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Çarçaf fenellate | **Set çarçafësh-** Set çarçafësh me 3 pjesë për krevat fëmijësh, të përbërë prej materiali 100% fanellate , me veti antibakteriale dhe antialergjike, i cili përfshin një çarçaf për mbulojë me përmasa 170cm x120 cm, një çarçaf për shtrojë me cepa të pajisur me material elastik, që nuk e lejojnë çarçafin të mblidhet gjatë gjumit, me përmasa 120cm x60cm, dhe një këllëf jastëku me përmasa 45cmx 60cm. | cope | 30 |
| 5 | Batanije femijesh | Batanije të trasha me permasa 120cmx100 cm | cope | 30 |
| 6 | Jastek Femijesh | **Jastëk me filtër-** Të jetë antimikrobal, antialergjik, ideale për fjetje dhe i butë në përdorim. Të krijojë rehati në mbështjetjen e kokës dhe qafës, efekt rehatues. Përmasat 40 cm x 55 cm. | cope | 15 |
| 7 | Hekur hekurosje | resioni: 35 gr / min<br>Kapaciteti depozitës/qeses: 300 ml<br>Fuqia: 2200 W<br>Tensioni: 220-240 V | cope | 2 |
| 8 | Tavoline ngrenie per femije | Karrigia për fëmijë 2 në 1 e përshtatshme për fëmijë mbi gjashtë muajsh. Karrigia mund te perdoret edhe si karrige ngrenie edhe si karrige per femije. Ulesja te jete prej plastike dhe mbulesa prej lëkure që pastrohet lehtë. Për mbrojtje shtesë, karrigia te kete nje rrip sigurie me 5 pika. | cope | 2 |
| 9 | Uturak femijesh | Uturak me deflektor te integruar i cili ndihmon per te mbajtur paster si femijen ashtu edhe tualetin me material jo toksik dhe i sigurt nga materiali pp<br>Dimensionet: 38*31.5*23cm | cope | 10 |
| 10 | Ndehese rrobash | Ndehese për të tharë të gjitha rrobat e femijeve . Te jete kundra ndryshkut dhe me strukturë të qëndrueshme, bërë tërësisht me aliazh alumini.<br>• Lartësia: 108 cm | cope | 2 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | • Ngjyra: E bardhë/blu<br>• Gjerësia: 55 cm<br>• Materiali: Celik/alumin<br>• Gjatësia: 202 cm | | |
| 11 | Kosha te medhenj per te mbajtur lodrat | Material i padepertueshem nga uji me permasa 32x32x54 | cope | 3 |
| 12 | Boks per femije | lehtesisht i montueshem ne forma 6kendore me permasa 65x65x130x113 | cope | 2 |
| 13 | Tavoline per nderrimin e bebeve | Tavoline Nderrimi me skelet mbajtes te pershtatshem per bebe 0-15Kg.Skeleti eshte me rrota. Skeleti paloset. | cope | 1 |
| 14 | Fshese me korent | Fshesë me korent 850 W Karakteristikat:<br>*Fuqia 850 W<br>*Tensioni 240 V<br>*Kapaciteti 1,5 L | cope | 1 |
| 15 | Perparese | 65% polyester, 35% pambuk. (Ose 100% pambuk )Gramatura: 200gr/m2, 240gr/m2, 290gr/m2, 320gr/m2.Me xhepa te bollshem.Jake me perforcim. Menge te gjata. | cope | 6 |
| 16 | Perde dritaresh | me permasat gjeresi 1.4ml x lartesei 1.6ml | cope | 5 |
| 17 | Perde dritaresh | me permasat gjeresi 1.6ml x lartesei 1.7ml | cope | 1 |

**Argumentimi i specifikimeve teknike:** *Argumentimi në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe bazuar në nevojat e institucionit.

Referuar Njoftimit të përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Nr. 8480 Prot, datë 30.12.2020, për nënshkrimin e një kontrate publike operatori ekonomik duhet të ketë:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.
- Kopje të Çertifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

**Mosplotësimi i këtyre kushteve sjell anulimin e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues, si rrjedhojë do të bëhet kalimi në njoftimin e operatorit të rradhës.**

- Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë bashkë me faturën fiskale edhe vërtetimin nga banka ku operon ku të jetë i vendosur NIPT, numri i llogarise dhe IBAN.

**ANËTARËT E KOMISIONIT TË BLERJEVE ME VLERË TË VOGËL**